

BIO E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES

ANDI BALLTA

Andi Ballta është drejtues i lartë në sektorin bankar dhe investitor, me një eksperiencë të gjerë në banking, investime në kapital privat (private equity) dhe financën korporative në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Evropë. Portofoli i tij i investimeve përfshin sektorin bankar, shoqëri financiare, pasuri të paluajtshme dhe tituj të listuar në bursë.

Ai është Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv (CEO) i Bankës Amerikane të Investimeve (ABI Bank), një bankë tregtare shqiptare me rreth 2 miliardë euro në vlerë asetesh. Z. Ballta është gjithashtu bashkëpronar i ABI Bank së bashku me NCH Capital dhe zotëron 80% të aksioneve të Bankës.

Z. Ballta mori drejtimin e ABI Bank në vitin 2015, pas blerjes së Crédit Agricole Albania, një transaksion i rëndësishëm që shënoi hyrjen e ABI Bank në tregun bankar shqiptar. Në vijim, ai udhëhoqi zgjerimin e Bankës përmes integritetit të institucioneve të tjera financiare, duke forcuar më tej pozicionin e saj në treg. Nën drejtimin e tij, ABI Bank është zhvilluar përmes blerjeve dhe investimeve strategjike, duke u konsoliduar si një prej institucioneve financiare kryesore në Shqipëri.

Nga viti 2008 deri në vitin 2016, Z. Ballta ka mbajtur pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv (Managing Director) në NCH Capital Inc., një shoqëri menaxhimi e kapitalit privat me seli në Nju Jork dhe me rreth 3 miliardë dollarë asete në menaxhim. Në këtë rol, ai ka drejtuar investimet e NCH Capital në Evropën Juglindore dhe Greqi. Gjithashtu, ai themeloi dhe drejtoi Tranzit Finance, një shoqëri financiare e licencuar nga Banka e Shqipërisë, e fokusuar në blerjen dhe administrimin e portofoleve të borxhit, mbledhjen e detyrimeve dhe financimin.

Përpara angazhimit të tij në NCH Capital, Z. Ballta ka punuar pranë Israel Discount Bank në Miami dhe Nju Jork, ku e nisi karrierën si Zëvendës Drejtor dhe më pas u promovua në Zëvendës Drejtor i lartë (Senior Vice President). Në Nju Jork, ai drejtoi financimet e grupeve të mëdha dhe ato sindikale me kredi komplekse dhe me risk të lartë. Në fillimet e karrierës së tij, Z. Ballta ka punuar me Agjencinë Gjermane të Zhvillimit GTZ (sot GIZ) në Shqipëri, ku ka kontribuar në projekte për mbështetjen e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe nxitjen e investimeve të huaja direkte.

Z. Ballta është diplomuar në Administrim Biznesi në Universitetin e Tiranës dhe ka përfunduar Masterin në Administrim Biznesi (MBA) në St. Thomas University, Miami, Florida.